

ROLI I ENTIT RREGULATOR TE ENERGJISE NE MROJTJEN E INTERESAVE TE KONSUMATOREVE

ERE trajton dhe zgjidh te gjitha ankesat dhe konfliktet direkte qe lindin nga maredheniet midis furnizuesit te energjise elektrike dhe konsumatoreve, duke pasur si qellim:

- Mbrojtjen e interesave te konsumatoreve ne aspektin individual.
- Mbrojtjen e interesave te konsumatoreve ne teresi nga abuzimet e aktoreve dominant ne tregun e energjise elektrike.
- Trajtim te barabarte dhe jodiskriminues te te gjithe konsumatoreve permes procedurave ligjore e transparente.
- Monitorimin dhe kontrollin e sherbimeve qe ofron i licensuari ndaj konsumatoreve te energjise elektrike.

KATEGORITE E MOSMARREVESHJEVE QE ZGJIDHEN NGA ERE

- Mosmarreveshjet e konsumatoreve me furnizuesit ne lidhje me permbushjen e detyrimeve kontraktuale te te licensuarit.
- Mosmarreveshjet e konsumatoreve me furnizuesit ne lidhje me cilesine e sherbimeve te ofruara nga furnizuesi dhe performancen e tij.
- Mosmarreveshjet ndermjet te licensuarve qe kane te bejne me maredheniet bilaterale te pjesemarresve te tregut.